VENDIM
Nr. 90, datë 7.6.2017

MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË PËRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA "ALBGAZ" SHA PËR PERIUDHËN 5.1.2017 – 20.9.2017

Në mbështetje të neneve 13 pika 2, 17 pika 1, germa "e", dhe 33 të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe nenit 19 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Çmimeve dhe Tarifave në lidhje me "Miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror për periudhën 5.1.2017 - 20.9.2017",

konstatoi se:

- Shoqëria "Albgaz" sh.a. është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.12.2016 "Për krijimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a. dhe përcaktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive "Albpetrol" sh.a. dhe "Albgaz" sh.a.".
- ERE, me vendimin nr. 82, datë 26.5.2017, vendosi certifikimin paraprak të shoqërisë "Albgaz" sh.a., si Operator i Kombinuar i gazit natyror në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet përkatëse të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror".
- Me anë të shkresës nr. 4, datë 20.2.2017, "Albgaz" sh.a. ka paraqitur në ERE kërkesën për miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror, bazuar në ligjin 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" dhe VKM 848, datë 7.12.2016, ku kërkon:

1. Për periudhën 5.1.2017 - 20.2.2017, tarifa e transmetimit të gazit natyror të jetë 15.27 lekë/m^3 me TVSH (pa TVSH, 12.725 lekë/m^3), tarifë kjo e rënë dakord me shoqërinë "Albpetrol" sh.a.
2. Për periudhën 20.2.2017 - 20.9.2017, tarifa e transmetimit të gazit natyror të jetë 40 lekë/m^3 me TVSH (pa TVSH, 33.33 lekë/m^3).

- ERE, me shkresën nr. 167/1, datë 28.2.2017, i kërkoi shoqërisë "Albgaz" sh.a. informacion të detajuar dhe argumentet përkatëse në lidhje me kostot e shërbimit të transmetimit të gazit natyror në zbatim të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s".
- Me anë të shkresës nr. 93/4, datë 13.3.2017, shoqëria "Albgaz" sh.a. paraqiti në ERE informacion shtesë për të argumentuar kërkesën për tarifë.
- ERE, në datë 29.3.2017, zhvilloi seancë dëgjimore me palët shoqëria "Albgaz" sh.a. dhe shoqërinë "Albpetrol" sh.a., me qëllim qartësimin e kërkesave në lidhje me aplikimin për tarifën e transmetimit të gazit natyror.
- U organizua një seancë dëgjimore në datë 19.5.2017, midis përfaqësuesve të shoqërive "Albgaz" sh.a. dhe "Albpetrol" sh.a., në të cilën u kërkua opinion nga shoqëria "Albpetrol" sh.a. për dakordësinë apo kontestim në lidhje me tarifën e transmetimit të propozuar nga shoqëria "Albgaz" sh.a. për vitin 2017.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria "Albgaz" sh.a. prej 25 lekë/m^3, për periudhën 5.1.2017 - 20.9.2017.
2. Përditësimi dhe kompensimi i të gjitha efekteve të mundshme financiare për shoqërinë "Albgaz" sh.a. për periudhën 5.1.2017 - 20.9.2017 do të bëhet në periudhën pasardhëse sipas përcaktimeve të nenit 17, pika "e" të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror".
3. Drejtoria Çmimeve dhe Tarifave të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti